



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 360/1 Prot

Datë 10.04 2018

AKT PËRPUTHSHMËRIE

PËR DOKUMENTET E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënavë elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor:
 - i. “Strategja Terroriale” - Bashkia Mirditë;
 - ii. “Plani i Zhvillimit Territorial” - Bashkia Mirditë;
 - iii. “Rregullorja e Planit” - Bashkia Mirditë;
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumenteve “Strategja Terroriale”, “Plani i Zhvillimit Territorial”, “Rregullorja e Planit” të Bashkisë Mirditë.



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR *

STRATEGJIA TERRITORIALE

PLANI I ZHVILLIMIT TERRITORIAL

RREGULLORJA E PLANIT

BAZA E TË DHËNAVE

BASHKIA MIRDITË

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK

Koordinator

Z. Ermal Pashollari

Ekspert GIS

Z. Sergio Merdani

Eksperte Ligjore

Znj. Borana Laçi

10.04.2018



Rezultatet dhe Detyrat		Përputhshmëria <i>VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 Plani i Përgjithshëm Kombëtar</i>
1. STRATEGJIA TERRITORIALE		
1.1. ANALIZA E TERRITORIT		
1.1.1. Analiza e dokumenteve që prekin territorin, të hartuara më parë	<p>1.1.1.1. Analiza e planeve, strategjive, planeve sektoriale në të gjitha nivelet, përfshirë zbatueshmërinë e tyre dhe çështje që duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit të ri.</p> <p>1.1.1.2. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësishë kombëtare që ndodhen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore dhe kufizimet që rrjedhin prej tyre.</p> <p>1.1.1.3. Analiza e elementeve përjashtuese dhe paraqitjen e tyre grafike në hartë.</p>	<i>Në përputhje</i>
1.1.2. Analiza e Përgjithshme e Territorit	<p>1.1.2.1. Analiza dhe vlerësimin i pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin ku ajo shtrihet, përfshirë identitetin historik, urban dhe ekonomik të territorit.</p> <p>1.1.2.2. Analiza e përgjithshme e gjendjes ekzistuese të territorit të njësisë vendore dhe atë metabolike të flukseve kryesore, e cila përmban elementet:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) topografik dhe klimatik; ii) gjeologo-inxhinierik; iii) hidrogeologjik dhe hidrografik; iv) makrozonimin dhe, sipas rastit, mikrozonimin sizmik; v) bonitetin e tokave, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës; <p>vi) burimet natyrore, si mqedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre, nëse ka të tilla në territorin përkatës;</p> <p>vii) zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike, nëse ka të tilla në territorin përkatës.</p>	<i>Në përputhje</i>

	1.1.2.3. Analiza mjedisore	<i>Në përputhje</i>
	1.1.2.4 Analiza e problematikës mjedisore, burimeve ndotëse dhe të dhëna për efektin e tyre në territor dhe shëndetin e njeriut	<i>Në përputhje</i>
	1.1.2.5. Analiza e përgjithshme e kushteve dhe të cilësisë fizike të strukturave e të territoreve, si bazë për hartimin e planeve të rigjenerimit, ripërtëritjes dhe/ose rizhvillimit	<i>Në përputhje</i>
	1.1.2.6. Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese, bazuar në njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrën e vendosjes së tyre në njësi (strukturore), skemën e rrjetit rrugor dhe të hapësirave publike, si dhe në lartësinë e strukturave	<i>Në përputhje</i>
	1.1.2.7. Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale, natyrore apo artificiale, që kanë ndikuar ose ndikojnë në formimin e vazhdueshëm të territorit në studim	<i>Në përputhje</i>
1.1.3. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet	1.1.3.1. Analiza e përdorimit ekzistues të tokës, bazuar në kategoritë bazë dhe nënkatgoritë e përdorimit të tokës, funksionet dhe aktivitetet, si dhe lidhjen e territorit vendor me rrjetet e infrastrukturave kombëtare	<i>Në përputhje</i>
1.1.4. Analiza dhe Vlerësimi Demografik	1.1.4.1. Shpërndarja dhe përqëndrimi i popullsisë në territor, lëvizjet mekanike dhe natyrore në vite	<i>Në përputhje</i>
1.1.5. Aspektet Sociale dhe Ekonomike	1.1.5.1. Analiza dhe vlerësimi ekonomik, përfshirë mundësitë lokale dhe pengesat për zhvillim ekonomik, konkurrueshmërinë ekonomike apo rajonale, pozicionimin dhe përqendrimin e poleve ekonomike lokale, cilësinë e kapitalit dhe të burimeve njerëzore, pika të forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të territorit	<i>Në përputhje</i>



	1.1.5.2. Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale, përshirë kriminalitetin, komunitetet e marginalizuara, etj.	<i>Në përputhje</i>
	1.1.5.3. Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit etj.	<i>Në përputhje</i>
	1.1.5.4. Analiza e periferialitetit, përfekt të së cilës në territor përcaktohen zona sipas kritereve të mëposhtme: i) largësia nga qendra/t e territorit urban; ii) largësia nga zonat ekonomike (qendrat e punësimit); iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor; iv) furnizimi me rrjete infrastrukturore dhe shërbime sociale; v) niveli i përafërt i tyre ardhurave të shtrresave shoqërore që ushtronjnë aktivitetin e tyre në zona të caktuara; vi) plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; vii) niveli i kriminalitetit dhe siguria e jetës; viii) probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social;	<i>Në përputhje</i>
	1.1.5.5. Analiza e nevojave për strehim përf të gjitha grupet shoqërore, sipas llojit dhe cilësisë së banesave ekzistuese, shpërndarjes së tyre në territor, sipërsfaqes së banimit për person dhe aksesit në shërbime	<i>Në përputhje</i>
1.1.6. Analiza e Infrastrukturës Ekzistuese	1.1.6.1. Infrastruktura rrugore, transporti dhe fluksi i lëvizjes së mjeteve (njësi/orë)	<i>Në përputhje</i>
1.1.7. Toka dhe Çështjet e Pronës	1.1.7.1. Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen, funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë	<i>Në përputhje</i>
	1.1.7.2. Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit	<i>Në përputhje</i>

1.2. STRATEGJIA TERRITORIALE

1.2.1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Planet Kombëtare dhe Sektoriale	1.2.1.1. Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar	<i>Në përputhje</i>
	1.2.1.2. Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin	<i>Në përputhje</i>
1.2.3. Rezultatet e Analizës së Territorit	1.2.2 Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor	<i>Në përputhje</i>
	1.3.1. Identifikimi i problematikave dhe potencialeve për secilin nga 5 sistemet territoriale	<i>Në përputhje</i>
1.2.4. Formulimi i vizionit dhe strategjisë për zhvillimin territorial të njësisë vendore	1.2.4.1. Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore	<i>Në përputhje</i>
	1.2.4.2. Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit të njësisë vendore	<i>Në përputhje</i>
	1.2.4.3. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve, si dhe duke konsideruar projekzionet e ndryshimeve në: - popullsi; - aktivitet ekonomik; - cilësi mjedisit; - infrastrukturë publike; - shërbime publike; - sisteme territoriale në tërësi (konvertim nga një sistem në tjetrin); - etj.	<i>Në përputhje</i>
1.2.5. Programet, Projektet e Zhvillimit dhe Planet e tyre të Veprimit	1.2.5.1. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë.	<i>Në përputhje</i>

10.04.2018



	<p>1.2.5.2. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fazat dhe termat kohorë; - përgjegjësitë; - ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore; - burimet njerëzore; - buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve; - treguesit monitorues të zbatimit. 	<i>Në përputhje</i>
1.2.6. Hartëzimi i Vizionit dhe Strategjisë së Territorit	1.2.6.1. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore si dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit	<i>Në përputhje</i>
	1.2.6.2. Hartat e 5 sistemeve ekzistuese dhe të propozuara territoriale së bashku me tabelat dhe treguesit përkatës për secilin sistem	<i>Në përputhje</i>

2. PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

2.1. Plani i Propozimeve Terroriale	<p>2.1.1. Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale: urban, infrastrukturor, bujqësor, ujor, natyror, së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.2. Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkatgorive të përdorimit të propozuar të tokës.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.3. Ndarja e territorit në njësi.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.4. Pozicionimi i rrjeteve të infrastrukturave, përfshirë hapësirat publike, dhe përcaktimi i kushteve teknike kryesore për realizimin e tyre.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.5. Zonat e rëndësishëm kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.6. Përcaktimi i zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban.</p>	<i>Në përputhje</i>

	<p>2.1.7. Tipologjitet e propozuara hapësinore, bazuar në përcaktimet e zonave/njësive për dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konsolidim, konservim, urbanizim.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.8. Përcaktimi i njësive, të cilat do t'i nënshtronen hartimit të PDV-ve sipas nenit 22 të ligjit, që parashikohet të kenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillim dhe/ose rizhvillim; - ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit; - investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit; - programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të neneve 30 dhe 31 të ligjit. 	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.9. Shpërndarja e popullsisë në territor sipas treguesve të parashikimit demografik dhe ekonomik, të specifikuar në nivel territori urban.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.10. Plani i strehimit, bazuar në nevojat e konstatuara dhe të projektuara, duke përcaktuar zonat/njësitë për dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konservim, urbanizim nëse janë zona të reja dhe territoret për programe sociale të strehimit.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>2.1.11. Përcaktimi i zonave/njësive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Transferimi i së drejtës për zhvillim; - Intensiteti me kushte; - Zhvillimi i detyrueshëm i tokës; - Preferimi; - Pezullimi i zhvillimit; - Servituti publik. 	<i>Në përputhje</i>
2.2. Plani i Mbrojtjes së Mjedisit	<p>2.2.1. Parashikimet për mbrojtjen e peizazhit.</p>	<i>Në përputhje</i> 

	2.2.2. Parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore.	<i>Në përputhje</i>
	2.2.3. Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra.	<i>Në përputhje</i>
	2.2.4. Parashtimi i dy variantave për zgjidhje të problematikës së evidentuar për sa u përket hotspoteve.	<i>Në përputhje</i>
	2.2.5. Parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit.	<i>Në përputhje</i>
2.3. Plani i Shërbimeve dhe Infrastrukturave Publike	<p>2.3.1. Infrastruktura publike që përfshin tërësinë e hapësirave dhe ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Transport; - Energji; - Administrim të ujit; - Komunikim elektronik; - Administrim mbetjesh dhe mbrojtje e mjedisit; - Administrim burimesh natyrore dhe kulturore; - Mbrojtje kombëtare, civile e kundër zjarrit; - Etj. 	<i>Në përputhje</i>
	2.3.2. Konsiderata nga planet e niveleve të tjera, sipas ndikimit në territorin vendor.	<i>Në përputhje</i>
	2.3.3. Tipologjia, cilësia, shpërndarja në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukim, shëndetësi etj.) ekzistuese dhe të propozuara.	<i>Në përputhje</i>

2.4. Plani i Veprimeve për zbatimin e PPV-së	2.4.1. Fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit për: - zonat me prioritet zhvillimi; - PDV-të; - rrjetet kryesore të infrastrukturave publike; - projektet prioritare/strategjike dhe projektet pilot.	<i>Në përputhje</i>
	2.4.2. Kosto e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të finançuara, të shoqëruara me planin e investimeve kapitale.	<i>Në përputhje</i>
	2.4.3. Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligor dhe administrativ në nivel vendor.	<i>Në përputhje</i>
	2.4.5. Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PPV-së.	<i>Në përputhje</i>
2.5. Shtojcat e PPV-së	2.5.1. Dokumentet e përmendura për zbatimin e PPV-së, studimet ndihmëse që merren nga institucionet përgjegjëse për sektorë të caktuar, si dhe studime për qëllime të veçanta që ndërmerrin nga vetë autoriteti vendor, sipas rastit.	<i>Në përputhje</i>
	2.5.2. Shtojcat I-II-III të PPV-së sipas formatit të Rregullores së Planifikimit.	<i>Në përputhje</i>

3. RREGULLORJA E PLANIT

3.1. Përkufizime dhe Shpjegime	3.1.1. Përkufizimet e termave të përdorur.	<i>Në përputhje</i>
	3.1.2. Shpjegimin e kodeve të përdorura për: - kategoritë dhe nënkatgoritë e përdorimit të tokës; - sistemet; - zonat; - njësitë; - kode të tjera sipas rastit	<i>Në përputhje</i>



3.2. Rregullat e Përdorimit të Tokës	<p>3.2.1. Kategoritë bazë dhe nënkatgoritë e përdorimit të tokës.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.2.2. Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.2.3. Përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.</p>	<i>Në përputhje</i>
3.3. Rregullat për çdo Zonë dhe Njësi	<p>3.3.1. Kushtet e zhvillimit:</p> <p>Në nivel <i>zone</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Kategoritë bazë; b. Nënkatgoritë; c. Aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara; d. Hapësira publike (S.UB.); e. Sipërfaqja bruto (S.UB.); f. Sipërfaqja neto (S.UB.); g. Sipërfaqja e infrastrukturës; h. Sipërfaqe Liqene, Lumenj, Përrrenj, Ligatina (S.U.); i. Dendësia/ha (S.UB.); j. Njësi banimi/ha (S.UB.); k. Gjelbërimi (S.UB.); l. Parkimi (S.UB.); m. Ndarja në njësi. <p>Në nivel <i>njësie</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Kategoritë dhe/ose nënkatgoritë e përdorimit të tokës; b. Aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara; c. Kushti për hartimin ose jo të PDV-së; d. Lloji i ndërhyrjes në territor (dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konservim, konsolidim, urbanizim); e. Intensiteti i lejuar i ndërtimit (I); f. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht); g. Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (Kshp); h. Koeficienti minimal i shfrytëzimit të territorit për rrugë (Kshr); i. Kushte për infrastrukturën; j. Lartësia e strukturave (në kate dhe metra); k. Treguesit e distancave; 	<i>Në përputhje</i>

	<ul style="list-style-type: none"> l. Tipologja e ndërtimit; m. Vija e kuqe/ndërtimit; n. Numri minimal i vendparkimeve publike; o. Nr. Banorësh; p. Nr. Përdoruesish; q. Shërbime; r. Kushte të tjera, sipas rastit. 	
	<p>3.3.2. Përcaktimi i instrumenteve të aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV-ve (nënndarja dhe bashkimi i parcelave, intensiteti i ndërtimit me kushte, transferimi i së drejtës për zhvillim, etj), përfshirë të drejtat dhe kufizimet ligjore që rrjedhin prej tyre.</p> <p>(referuar Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit – nenet 30-31, Rregullores së Planifikimit – neni 56, Rregullores së Zhvillimit – nenet 29-31; 41-44, si dhe Dokumentit të Politikave për Instrumentet Financiare për Zhvillimin e Tokës nga USAID-plgp).</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.3.3. Tabela përbledhëse e të dhënave kryesore për të gjitha njësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i tokës, - ndërhyrja në territor, - kushti për PDV, - instrumenti për drejtimin e zhvillimit, - I, - Ksht, - nr. katesh, - nr. Banorësh. 	<i>Në përputhje</i>
3.4. Rregullat e Sistemit Rrugor dhe të Transportit	<p>3.4.1. Përcaktimi dhe përshkrimi i kategorive të rrjetit rrugor, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.4.2. Kushtet teknike dhe përmasat.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.4.3. Parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit publik, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.</p>	<i>Në përputhje</i>
	<p>3.4.4. Përcaktimi i vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë dy anëve të trupave rrugorë.</p>	<i>Në përputhje</i>
3.5. Rregullat e Ruajtjes së Mjedisit, Peizazhit, Burimeve	<p>3.5.1. Normat dhe standartet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm</p>	<i>Në përputhje</i>

Natyrore, Zonave dhe Objekteve të Trashëgimisë Kulturore	në fuqi.	
	3.5.2. Normat, standaret dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore.	<i>Në përputhje</i>
	3.5.3. Përcaktimi i vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu).	<i>Në përputhje</i>
	3.5.4. Rregulla arkitektonike dhe estetike.	<i>Në përputhje</i>
	3.5.5. Rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.	<i>Në përputhje</i>

4. MATERIALI HARTOGRAFIK dhe BAZA E TË DHËNAVE e PPV-së *

4.1. Hartat e PPV-së	4.1.1. Hartat shoqërojnë dhe pasqyrojnë të gjitha pjesët përbërëse të dokumentit të PPV-së, sipas <i>Shtojcës I të Rregullores së Planifikimit</i> : <ul style="list-style-type: none"> - me shkallë prezantimi që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000, me përjashtim të analizave në nivel rajoni apo hartave të infrastrukturave publike, kur këto paraqesin elemente që ndodhen jashtë territorit administrativ, si dhe nga 1:5,000 deri në 1:10,000, për zona të rëndësishme urbane; - me simbolet grafike të planifikimit; - në përputhje me specifikimet për bazat e të dhënavë, të përcaktuara në rregulloren e regjistrat, në zbatim të ligjit. 	<i>Në përputhje</i>
4.2. Baza e të dhënavë	4.2.1. Baza e të dhënavë të integruarat të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të regjistrat të integruarat të territorit.	<i>Në përputhje</i>

* “Analiza dhe Vlerësimi i Thelluar i Territorit, Bashkia Mirditë”, “Strategjia Territoriale, Vizioni Strategjik, Objektivat e Zhvillimit, Bashkia Mirditë”, “Plani i Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mirditë”, “Rregullore Vendore, Bashkia Mirditë”, “Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë”, botuar në Regjistrin e Integruarat të Territorit më datë 06.04.2018 me titull “Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë, per AKT-Perputhshmerine”.

**UDHËZIME PËR MIRATIMIN E PPV-SË
NË KËSHILLIN BASHKIAK DHE KËSHILLIN KOMBËTAR TË TERRITORIT**

A. DOKUMENTET PËR SHQYRTIM

Bazuar në VKM nr. 686, dt. 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, materialet që duhen botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit përparrë miratimit të PPV-SË, janë:

1. **Nisma e miratuar dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;**

2. **Dokumentet përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor:**

- 2.1. Strategjia Territoriale, shoqëruar me gjetjet e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - 2.2. Plani i Zhvillimit të Territorit;
 - 2.3. Rregullorja e Planit;
 - 2.4. Vlerësimi Strategjik Mjedor;
-
- 2.5. Materiali Hartografik;
 - 2.6. Baza e të dhënave të integruar të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të RKPT.

3. **Akti i Përputhshmërisë nga AKPT;**

4. **Deklarata Mjedisore nga Ministri i Mjedisit për VSM-në.**

B. DOKUMENTET PËR MIRATIM

- **TEKST** – Miratim në KB dhe KKT

Plani i Përgjithshëm Vendor, i përbërë nga:

1. **Strategjia Territoriale**, shoqëruar me gjetjet e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;

2. **Plani i Zhvillimit të Territorit**, shoqëruar me:

3. **Rregullorja e Planit.**

- **HARTA** – Miratim në KB dhe KKT

1. **Vizioni Strategjik;**

2. **Ndarja e Territorit në 5 Sisteme;**

3. **Ndarja e Territorit në Njësi;**

4. **Përdorimi i Tokës sipas 14 Kategorive Bazë;**

5. **Infrastruktura e Transportit;**

6. **Fazat e Zbatimit të PPV-së.**

- **HARTA** – Miratim në KB

Këshilli Bashkiak miraton, përvèç 6 hartave të mësipërme që miratohen edhe nga KKT, të gjitha hartat e tjera ku reflektohen propozime të planit, që i përkasin Strategjisë Territoriale dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

